



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0150
Data e Vendimit: 31.03.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, dhe nenin 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr.01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30.09.2022, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 24.03.2023, të parashtruar nga OE “Pro Tech Clean” SH.P.K., për tërheqje nga ankesa e parashtruar me datë: 31/03/2023 me nr. 2023/0150 kundër Njoftimit B 54 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 31/03/2023, mori këtë:

Vendim

- 1. Aprovohet**, kërkesa e datës 24/03/2023, e parashtruar nga “Pro Tech Clean” SH.P.K., për tërheqjen e ankesës me nr. 2023/0150, e datës 20/03/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.
3. Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa dhe pretendimet ankimore, duke u bazuar në nenin 31 paragrafi 4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE ankues i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
4. Obligohet OE ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Pro Tech Clean” SH.P.K., me seli në Prishtinë, me datën 20/03/2023, ka paraqitur ankesë në OSHP, kundër Njoftimit B54 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke pretenduar në shkelje të neneve: 1, 6, 7, 27, 28, 29, 40, 51, 53, 56, 66, 68 dhe 69 të LPP-së.

OSHP ka verifikuar në sistemin elektronik për ankesën në fjalë dhe pas verifikimit ka konstatuar se tek rubrika e ankesave figuron se ankesa e lartcekur është tërhequr nga OE ankues “Pro Tech Clean” SH.P.K., me datë 24.03.2023.

Kryetarja e OSHP-së pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankues “Pro Tech Clean” SH.P.K., me seli në Prishtinë, bazuar në arsyet e dhëna nga ankuesi për tërheqje nga ankesa në fjalë, mori vendim me të cilin e aprovon si të bazuar kërkesën e OE ankues për tërheqje nga ankesa dhe pretendimet ankimore të ankesës nr. 2023/0150 të datës 20/03/2023.

Vendimi për tarifën e sigurimit të ankesës u more në pajtim me paragrafin 4 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

Kryetarja e OSHP-së pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Pro Tech Clean SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: